



Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade



AGJENCIONI I REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

RAPORTI I INDIKATORËVE BAZË TË PERFORMANCËS PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE NË KOSOVË PËR PERIUDHËN: TETOR-DHJETOR 2022

AGJENCIA PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE TË KOSOVËS

JANAR 2022

PËRMBAJTJA

I. HYRJE.....	3
II. KOHËZGJATJA E REGJISTRIMIT TË SHOQËRIVE TREGTARE	4
III. KOHËZGJATJA E REGJISTRIMIT TË SHPK-VE	4
IV. KOHËZGJATJA PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS QENDRAVE TË REGJISTRIMIT	6
V. REGJISTRIMI DHE ÇREGJISTRIMI SIPAS FORMËS LIGJORE TË SHOQËRIVE TREGTARE.....	7
VI. REGJISTRIMI I DEGËVE TË SHOQËRIVE TË HUAJA TREGTARE SIPAS SHTETIT TË ORIGJINËS	7
VII. NUMRI I SHOQËRIVE TREGTARE NË TË CILAT ËSHTË I PËRFSHIRË SË PAKU NJË PRONAR, ORTAK OSE AKSIONAR I HUAJ	8
VIII.REGJISTRIMI I SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS GJINISË	9
IX. PËRMBLEDHJE NGA ARBK PËR TREMUJORIN E KATËRT TË VITIT 2022 (T4 TETOR-DHJETOR 2022).....	10
X. PËRMBLEDHJE NGA ARBK VITI 2000 – DHJETOR 2022	11

I. HYRJE

Ky raport paraqet rezultatet e indikatorëve të performancës lidhur me procesin e regjistrimit të shoqërive tregtare në Kosovë për tremujorin e katërt të vitit 2022, punuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm “ARBK”)

Gjatë kësaj periudhe, një ekip i përbërë nga zyrtarët e ARBK-së nga fusha e Teknologjis Informative kanë analizuar një sërë indikatorësh të lidhur me performancën e ARBK-së:

- Kohëzgjatjen për regjistrimin e shoqërive tregtare në përgjithësi në Kosovë dhe për Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar në veçanti, si dhe sipas qendrave të regjistrimit;
- Numrin total të shoqërive tregtare të regjistruara sipas formës ligjore dhe numrin total të shoqërive tregtare të çregjistruara sipas formës ligjore të shoqërive tregtare;
- Numrin total të degëve të shoqërive të huaja tregtare të regjistruara sipas shtetit të origjinës;
- Numrin e pronarëve, ortakëve ose aksionarëve të huaj të përfshirë në shoqëritë tregtare të Kosovës sipas llojit të shoqërive tregtare;
- Përqindjen e bizneseve individuale sipas gjinisë; dhe
- Përqindjen e ortakëve ose aksionarëve sipas gjinisë në shoqëritë tregtare në Kosovë.

Ky raport analizon të dhënat e nxjerra nga regjistri i ARBK-së për shoqëritë tregtare që sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare¹ në Kosovë kërkohen të regjistrohen në ARBK. Sipas këtij ligji, ARBK regjistron pesë forma themelore të shoqërive tregtare: (1) Bizneset Individuale, (2) Ortakëritë e Përgjithshme, (3) Ortakëritë e Kufizuara, (4) Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuara dhe (5) Shoqëritë Aksionare. Përveç këtyre formave themelore në ARBK regjistrohen edhe (1) Degët e Shoqërive të Huaja Tregtare, (2) Zyrtat e Përfaqësisë të Shoqërive të Huaja Tregtare, (3) Ndërmarrjet Publike sipas ligjit në fuqi për ndërmarrjet publike, (4) Ndërmarrjet Shoqërore nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe (5) Çfarëdo subjekti tjetër që me ligj të veçantë kërkohet të regjistrohet në ARBK si p.sh. Kooperativat Bujqësore.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (T4 2021), në këtë tremujor (T4 Tetor-Dhjetor 2022) vërehet një përmirësim në kohëzgjatje së regjistrimit për të gjitha shoqëritë tregtare prej **6%**.


Kufizimet e raportit: Për qëllime të këtij raporti, **kohëzgjatja** është llogaritur duke pas parasysh vetëm ditët e punës prej datës së aplikimit deri në aprovimin e aplikacionit për regjistrim. Ky raport nuk bën ndonjë supozim dhe nuk ofron shifra lidhur me shoqëritë tregtare që janë aktive dhe funksionojnë në Kosovë, mirëpo fokusohet kryesisht në matjen e efikasitetit të ARBK-së dhe qendrave komunale të regjistrimit në zhvillimin e procedurave të regjistrimit ose çregjistrimit të shoqërive tregtare. Për të marrë një pasqyrë më të qartë të numrit, madhësisë, dhe statusit funksional të shoqërive tregtare dhe subjekteve tjera ekonomike të angazhuara në veprimtari ekonomike në Kosovë, ekziston nevoja për një përpjekje më gjithëpërfshirëse duke përfshirë institucionet tjera qeveritare, në radhë të dytë Administratën Tatimore të Kosovës dhe Ministrinë e Administratës Publike.

¹ Ligji Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16426>

II. KOHËZGJATJA E REGJISTRIMIT TË SHOQËRIVE TREGTARE

Shoqëritë tregtare, siç përcaktohet në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, kërkohen të regjistrohen në zyrën qendrore të ARBK-së në Prishtinë ose në njërin nga 29 qendrat komunale për regjistrimin e shoqërive tregtare nëpër Kosovë. Kjo pjesë e raportit paraqet kohëzgjatjen e regjistrimit të shoqërive tregtare duke llogaritur vlerën mesatare të diferencës së ditëve të punës që nga data aplikimit deri tek data e aprovimit. Kohëzgjatja e regjistrimit për të gjitha shoqëritë tregtare gjatë tremujorit të katërt të vitit 2022 (T4 Tetor-Dhjetor 2022) ishte **3.26 ditë**, ku vërehet një përmirsim prej **6 %** krahasuar me 3.45 ditë sa ishte në tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (T4 Tetor-Dhjetor 2021).


Grafiku 1: Kohëzgjatja mesatare për regjistrimin e të gjitha formave të shoqërive tregtare, Tetor-Dhjetor 2022 (T4 2022) dhe krahasimi me Tetor-Dhjetor 2021 (T4 2021):



III. KOHËZGJATJA E REGJISTRIMIT TË SHPK-VE


Kjo pjesë e raportit paraqet vetëm kohëzgjatjen e regjistrimit të një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK). Kohëzgjatja mesatare e regjistrimit vetëm e SHPK-ve në të gjitha qendrat e regjistrimit përfshirë edhe qendrën kryesore në Prishtinë (**Grafiku 2**) gjatë tremujorit të katërt të vitit 2022 (T4 Tetor-Dhjetor 2022) ishte **3.90 ditë**, ku vërehet një përmirësim prej **1%** krahasuar me 3.94 ditë sa ishte në tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (T4 Tetor-Dhjetor 2021).

Grafiku 2: Kohëzgjatja mesatare vetëm për regjistrimin e SHPK-ve, Tetor-Dhjetor 2022 (T4 2022) dhe krahasimi me Tetor-Dhjetor 2021 (T4 2021):



Për më tepër, **Grafiku 3** tregon kohëzgjatjen për regjistrimin e SHPK-ve vetëm në qendrën e regjistrimit të ARBK-së në Prishtinë. Kohëzgjatja mesatare e regjistrimit vetëm e SHPK-ve në Prishtinë (**Grafiku 3**) gjatë tremujorit të katërt të vitit 2022 (T4 Tetor-Dhjetor 2022) ishte **4.16ditë** ku vërehet një përmirsim prej **5%** krahasuar me **4.39** ditë sa ishte në tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (T4 Tetor-Dhjetor 2021).

Grafiku 3: Kohëzgjatja mesatare për regjistrimin e SHPK-ve vetëm në qendrën e regjistrimit të ARBK-së në Prishtinë, Tetor-Dhjetor 2022 (T4 2022) dhe krahasimi me Tetor-Dhjetor 2021 (T4 2021):



IV. KOHËZGJATJA PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS QENDRAVE TË REGJISTRIMIT

Tabela I tregon kohëzgjatjen mesatare për regjistrimin e të gjitha formave të shoqërive tregtare të ndara në 29 qendrat komunale për regjistrim si dhe në zyrën qendrore të ARBK-së në Prishtinë. Ndarja sipas qendrave të regjistrimit në tabelën më poshtë është bazuar në supozimin se nëse një shoqëri tregtare e ka adresën e regjistrimit p.sh në qytetin e Gjilanit, atëherë e njëjta po ashtu edhe është regjistruar në qendrën e regjistrimit në Gjilan, edhe pse ekziston mundësia që ajo shoqëri tregtare të jetë regjistruar në qendrën kryesore të ARBK-së në Prishtinë. Kjo është për arsye se ARBK aktualisht ka një sistem unik të regjistrimit të shoqërive tregtare i cili përfshin të dhënat për shoqëritë tregtare të regjistruara në të gjithë territorin e Kosovës, por jo sipas qendrave të regjistrimit.

Tabela I: Kohëzgjatja për regjistrimin e shoqërive tregtare sipas Qendrave për Regjistrimin e Shoqërive Tregtare, Tetor-Dhjetor 2022:

Qendra e Regjistrimit	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Mesatarja	Nr. i shoqërive tregtare
Deçan	2.43	3.75	3.18	3.15	26
Dragash	2.33	3.33	1.50	2.12	17
Ferizaj	4.42	2.87	3.72	3.64	233
Fushë Kosovë	3.27	3.42	3.38	3.36	110
Gjakovë	3.15	2.74	2.03	2.67	113
Gjilan	3.33	3.11	3.57	3.32	135
Glllogoc	4.71	2.76	2.76	3.59	67
Graçanicë	5.46	3.50	2.95	3.86	42
Hani i Elezit	1.00	2.67	3.00	2.73	11
Istog	2.47	2.00	2.09	2.24	37
Kaçanik	2.15	2.35	2.78	2.38	48
Kamenicë	1.71	1.45	2.91	2.07	29
Klinë	4.60	2.91	2.42	3.00	28
Lipjan	3.64	3.00	2.65	3.07	72
Malishevë	3.08	2.86	3.20	3.00	31
Mamush	7.00		2.58	3.21	15
Mitrovicë	2.97	3.02	2.50	2.90	108
Mitrovicë Veriore	3.00	1.00	2.00	2.57	7
Novobërdë	4.50		2.00	3.25	4
Obiliq	2.50	2.58	3.00	2.68	25
Pejë	2.55	2.18	2.30	2.32	143
Podujevë	2.67	2.81	1.85	2.46	82
Prishtinë	3.69	4.15	4.10	3.98	809
Prizren	3.09	2.64	2.60	2.77	178
Rahovec	2.20	2.36	1.60	2.00	36
Shtërpçë	3.00	1.00	3.25	2.86	7
Shtime	1.57	2.50	2.75	2.18	18
Skenderaj	2.58	2.89	2.33	2.67	39
Suharekë	3.61	2.22	2.43	2.90	41
Viti	2.35	2.80	3.00	2.72	60
Vushtrri	3.07	2.70	3.03	2.94	70
Mesatarja	2.96	2.73	3.08	2.92	2641

*Ngjyra e kuqe paraqet mesatare të madhe të ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare.

*Ngjyra e gjelbër paraqet mesatare të vogël të ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare.

V. REGJISTRIMI DHE ÇREGJISTRIMI SIPAS FORMËS LIGJORE TË SHOQËRIVE TREGTARE

Tabela 2 më poshtë paraqet numrin e shoqërive tregtare të regjistruara si dhe numrin e shoqërive tregtare të çregjistruara sipas formës ligjore të shoqërive tregtare të definuara me ligj për muaj, nga muaji Tetor deri në Dhjetor të vitit 2022. Forma ligjore me numrin më të madh të regjistruarve gjatë këtij tremujori ka qenë Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, pasuar nga Biznesi Individual. Forma ligjore me numrin më të madh të shuarjeve për këtë periudhë ishte Biznesi Individual, pasuar nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar.

Tabela 2: Numri i shoqërive tregtare të regjistruara dhe çregjistruara sipas formës ligjore, Tetor-Dhjetor 2022:

SHOQËRI TREGTARE	Muaji											Totali
		(1) Biznes Individual	(2) Ortakëri e Përgjithshme	(3) Ortakëri e Kufizuar,	(4) Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	(5) Shoqëri Aksionare	(1) Degë e Shoqërive të Huaja Tregtare	(2) Zyrë e Përfaqësive të Shoqërive të Huaja Tregtare	(3) Ndërmarrjet Publike	(4) Ndërmarrjet Shoqërore	(5) Kooperativa Bujqësore	
TË REGJISTRUARA	Tetor	280	/	/	552	/	5	/	/	/	/	837
	Nëntor	370	/	/	597	2	5	/	/	/	/	974
	Dhjetor	232	1	1	591	/	4	1	/	/	/	830
	Totali	882	1	1	1740	2	14	1	/	/	/	2641
TË ÇREGJISTRUARA	Tetor	109	4		13		1					127
	Nëntor	120	2		21	1	3				1	148
	Dhjetor	153	1		26		2					182
	Totali	382	7		60	1	6				1	457

VI. REGJISTRIMI I DEGËVE TË SHOQËRIVE TË HUAJA TREGTARE SIPAS SHTETIT TË ORIGINËS

Në bazë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, në ARBK dhe Qendrat Komunale të Regjistrimit bëhet regjistrimi edhe i degëve të shoqërive të huaja tregtare. **Tabela 3** më poshtë tregon numrin total të degëve të shoqërive të huaja tregtare të regjistruara në Kosovë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, për periudhën Tetor-Dhjetor 2022.

Tabela 3: Degët e shoqërive të huaja tregtare të regjistruara në Kosovë sipas shtetit të origjinës, Tetor-Dhjetor 2022:

Shteti i originës	Numri i degëve të shoqërive të huaja tregtare
Bullgaria	1
E.e bashkuara arabe	1
Maqedonia e Veriut	1
Shqipëria	4
Turqi	1
Zvicer	3
Shtetet e bashkuara	2
Totali	11

VII. NUMRI I SHOQËRIVE TREGTARE NË TË CILAT ËSHTË I PËRFSHIRË SË PAKU NJË PRONAR, ORTAK OSE AKSIONAR I HUAJ

Për ta vlerësuar pjesëmarrjen e personave të huaj si pronarë, ortakë ose aksionarë në shoqëri tregtare në Kosovë janë paraqitur të dhënat në **Tabelën 4**, të cilat tregojnë numrin e shoqërive tregtare në të cilat është i përfshirë së paku një pronar, ortak ose aksionar i huaj, mirëpo kjo nuk tregon kapitalin e investuar nga personat e huaj. Gjatë periudhës Tetor-Dhjetor 2022 janë regjistruar gjithsej 2,641 shoqëri tregtare nga të cilat 217 kanë të paktën një person të huaj fizik ose juridik si pronar, ortak ose aksionar, ku nga kjo tabelë janë përjashtuar degët e shoqërive të huaja tregtare pasi që ato janë të paraqitura më lartë në **Tabelën 3**.


Tabela 4: Numri i të gjitha shoqërive tregtare (përjashtuar degëve) në të cilat është i përfshirë së paku një pronar, ortak ose aksionar i huaj, Tetor-Dhjetor 2022 (T4 2022):

SHOQËRI TREGTARE	Muaji											Totali
		(1) Biznes Individual	(2) Ortakëri e Përgjithshme	(3) Ortakëri e Kufizuara,	(4) Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara	(5) Shoqëri Aksionare	(6) Degë e Shoqërive të Huaja Tregtare	(7) Zyrë e Përfqisës të Shoqërive të Huaja Tregtare	(8) Ndërmarrjet Publike	(9) Ndërmarrjet Shoqërore	(10) Kooperativa Bujqësore	
TË REGJISTRUARA	Tetor	7	0		70	1		0	0	0	0	77
	Nëntor	3	0		72	1		0	0	0	0	76
	Dhjetor	4	0	1	58			1	0	0	0	64
	Totali	14	0	1	200	1		1	0	0	0	217


VIII. REGJISTRIMI I SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS GJINISË

Të dhënat në **Grafikun 4 dhe 5** paraqesin pjesëmarrje sipas gjinisë në shoqëritë tregtare të regjistruara gjatë periudhës Tetor-Dhjetor 2022. Për shkak të natyrës së formave të ndryshme ligjore të shoqërive tregtare, të dhënat më poshtë paraqiten ndaras për Bizneset Individuale, të cilat kanë pronar të vetëm dhe janë zakonisht biznese të vogla, dhe ndaras për format ligjore të tjera të shoqërive tregtare ku pronarët marrin pjesë si ortakë apo aksionarë në shoqëri tregtare më të mëdha ose më diverse.


Grafiku 4: Përqindja e Bizneseve Individuale sipas Gjinisë, Tetor-Dhjetor 2022 (T4 2022):



Grafiku 5: Përqindja e Ortakëve dhe Aksionarëve sipas Gjinisë, Tetor-Dhjetor 2022 (T4 2022):



IX. PËRMBLEDHJE NGA ARBK PËR TREMUJORIN E KATËRT TË VITIT 2022 (T4 TETOR-DHJETOR 2022)



Kohëzgjatja



X. PËRMBLEDHJE NGA ARBK VITI 2000 – DHJETOR 2022

224,683

Shoqëri Tregtare
të **regjistruara**



32,644

Shoqëri Tregtare
të **çregjistruara**

